



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 2264 / Prot.  
17

Tiranë, më 07.05.2024

V E N D I M

Nr. 10, datë 07.05.2024

P Ë R

*Miratimin e qëndrimit të AKEP për komentet/sugjerimet e paraqitura gjatë këshillimit publik të dokumentit "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz".*

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

|      |                |         |
|------|----------------|---------|
| Z.   | Tomi Frashëri  | Kryetar |
| Znj. | Edlira Dvorani | Anëtar  |
| Z.   | Lorenc Bako    | Anëtar  |
| Z.   | Bleron Dokle   | Anëtar  |
| Z.   | Armer Juka     | Anëtar  |

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 07.05.2024, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Funkzionimit të Këshillit Drejtues të AKEP miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjit nr. 8480 datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", me propozim të Grupit të Punës, shqyrtoi kërkesën me objekt:

*Miratimin e qëndrimit të AKEP për komentet/sugjerimet e paraqitura gjatë këshillimit publik të dokumentit "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz".*

BAZA LIGJORE:

1. Pika 10 e nenit 5, shkronja g) dhe gj) të nenit 8, pika 2 e nenit 65, dhe pika 5 e nenit 68, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (ligji nr. 9918);

2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në RSH” (Ligji nr.44/2015);
3. VKM nr. 1187 datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (PKF);
4. VKM nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe të planit të veprimit”;
5. VKM nr. 1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar me VKM nr. 501/2010, VKM nr. 469/2014 dhe VKM nr. 635 datë 15.7.2015;
6. Planin e Përdorimit të Frekuencave (PPF), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 7 datë 06.09.2023;
7. Rregullore nr. 30 datë 05.12.2013 “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”.
8. Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 21 datë 7.12.2021;

### KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti qëndrimi i AKEP për komentet/sugjerimet e palëve të interesuara, të paraqitura gjatë këshillimit publik;
2. Projekt-Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;

### V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 3 datë 07.02.2024, ka miratuar për Këshillim Publik dokumentin “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz”. Procedura e këshillimit publik u zhvillua nga data 07.02.2024 deri në datën 07.04.2024.
2. Gjatë këshillimit publik, AKEP ka administruar komentet/sugjerimet e depozituara nga sipërmarrësit One Albania sh.a dhe Vodafone Albania sh.a, si dhe nga Ministria e Brendshme.
3. Në përfundim të këshillimit publik, Grupi i Punës, ka përgatitur dokumentin me qëndrimin e AKEP për komentet/sugjerimet e palëve të interesuara, të paraqitura gjatë këshillimit publik.
4. Këto dokumente janë në përputhje me përcaktimet ligjore dhe rregullatore, Planin Kombëtar të Frekuencave, dokumentet strategjike spektrale dhe broadband të Qeverisë Shqiptare, dokumentin strategjik të AKEP për teknologjitë e reja broadband, Vendimet/Rekomandimet përkatëse të ITU/CEPT, Vendimet/Rekomandimet përkatëse të Komisionit Europian (ECC) dhe zhvillimet e këtij spektri në vendet e BE dhe Rajonit.

### ARSYETON:

1. Bazuar në nenet 6, 7 dhe 8, të Ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, AKEP është autoriteti i vetëm rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, përgjegjës për të nxitur/promovuar konkurrencën efçente me qëllim dhe përdorimin e frytshëm të frekuencave dhe për lëshimin e autorizimeve individuale për përdorimin e brezave të frekuencave sipas Planit Kombëtar të

Frekuencave (miratuar me VKM Nr. 1187, datë 24.12.2020), si dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave (miratuar me Vendimin nr. 6, datë 31.03.2022 të Këshillit Drejtues të AKEP).

2. Në nenin 5, pika 2 dhe nenin 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit”, përcaktohet qartësisht objektivi strategjik për nxitjen e administrimit dhe përdorimit eficient të spektrit radio, për të përmbushur në kohë dhe më mirë kërkesën në rritje për përdorim të frekuencave, me vlerë të rëndësishme sociale, kulturore dhe ekonomike, si dhe përmirësimi i fleksibilitetit në përdorimin e spektrit radio, për të promovuar inovacionin dhe investimet, nëpërmjet mundësisë së përdorimit të teknologjive të reja.
3. Synimet kryesore të AKEP, në procesin e këshillimit publik, ishin:
  - Nxitja e një konkurrence sa më efektive në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri.
  - Përdorimin sa më të frytshëm të radio frekuencave, në rastet e kufizimit të tyre.
  - Përmbushja me sukses e politikës spektrale dhe politikës së zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike;
4. Këshillimi publik u zhvillua konform përcaktimeve ligjore, lidhur me radio frekuencat që do të caktohen, numrin e pritshëm të drejtave të përdorimit, kushtet që mendohet të vendosen për këto të drejta përdorimi, kërkesën që palët e interesuara të shprehin mendimin e tyre për vlerën e tregut të frekuencave dhe të gjitha çështjet, për të cilat AKEP ishte i interesuar të marrë opinionin e palëve të interesuara.
5. Dokumenti qëndrimi i AKEP për komentet/sugjerimet gjatë këshillimit publik, vjen në përputhje me qëllimin e këshillimit publik “Mbi dhënien në përdorim të frekuencave të paalokuara të brezit 3400-3800 MHz”, dhe konkretisht:
  - U krijua një panoramë e qartë për impaktin që do të ketë dhënia në përdorim e frekuencave të këtij brezi, nga palë të interesuara;
  - U shpreh interesi për marrjen në përdorim të tyre (numri i kërkesave);
  - U shpreh nga palët e interesuara çmimi që janë të gatshëm të ofrojnë për një sasi të caktuar spektri në këtë brez frekuencash;
  - U shpreh qëndrimi i tregut për mënyrën e vlerësimit dhe kritereve në procedurën e tenderit.
  - U përcaktuan indikatorët për kushtet teknike të përdorimit të frekuencave dhe kohëzgjatjes së autorizimeve individuale të brezit 3400-3800 MHz.

### PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008, si dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 68, të ligjit nr. 9918/2008 dhe pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr. 34/2017, K.Pr.A, dhe Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, duke çmuar rëndësinë e vijimit të procesit, interesin publik dhe përputhshmërinë ligjore, Këshilli Drejtues i AKEP;

### V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentin me qëndrimin e AKEP për komentet/sugjerimet e paraqitura gjatë këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz”, i cili jepet bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar**

**Tomi Frashëri**



**Anëtar**

**Edlira Dvorani**

**Anëtar**

**Lorenc Bako**

**Anëtar**

**Bleron Dokle**

**Anëtar**

**Armer Juka**